

Si të shkruajmë një Projekt



Shtator, 2024

Udhëzues për institucionet arsimore.

Përmbajtja

HYRJA.....	3
I. HARTIMI I PROJEKTIT.....	4
FAZA PËRGATITORE – ANALIZA E SITUATËS	4
1. Identifikimi i problemit:	4
2. Vendosja e objektivave të qarta.....	5
3. Palët e interesuara dhe përfituesit.....	5
4. Mbledhja e informacionit nga mjedisi rrethues:.....	6
5. Pritshmëritë: 6	
6. Këndvështrimi i donatorit:	6
Krijimi i partneriteteve efektive	7
PËRGATITJA E NJË PROJEKT PROPOZIMIT.....	7
SHTJELLIMI I ELEMENTEVE TE PROJEKT PROPOZIMIT.....	9
TITULLI I PROJEKTIT	9
TË DHËNAT E APLIKUESIT.....	10
KOHËZGJATJA E PROJEKTIT	10
PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT/JUSTIFIKIMI I PROJEKTIT.....	10
ANALIZA E KONTEKSTIT	11
QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT.....	13
PËRFITUESIT	15
REZULTATET E PRITSHME.....	15
AKTIVITETET E PROJEKTIT	16
KALENDARI I AKTIVITETEVE.....	17
QËNDRUESHMËRIA E PROJEKTIT.....	18
BUXHETI I DETAJUAR	19
II.SHEMBUJ PROJEKTESH TË SHKOLLËS	20
Shkolla 9 vjeçare “Sulë Misiri”, Elbasan	20
Shkolla 9 vjeçare “Ali Xhetani”, Mat.....	24
Shkolla 9 vjeçare “Çajupi”, Gjirokastër	29
Kopshti nr.3, Mat.....	33
Shkolla 9 vjeçare “Mustafa Gjestila”, Mat.....	38
Shkolla 9 vjeçare LAZARAT, Gjirokastër	45

HYRJA

Një projekt përfshin një sërë aktivitete të cilat synojnë të zgjidhin një problem specifik duke arritur objektiva të qarta brenda një afati kohor dhe buxheti të caktuar. Projektet realizohen në kuadër të thirrjeve specifike për grante, të cilat nëse janë të suksesshme, marrin financim nga donatori përkatës për t'u zbatuar. Megjithatë, për të hartuar një projekt-propozim të mirë kërkohet kohë, përkushtim dhe eksperiencë në këtë fushë.

Ky moduli është konceptuar dhe zhvilluar për të ndihmuar institucionet arsimore, duke i fuqizuar ato përmes ofrimit të procedurave, hapave dhe krijimit të mundësive për hartimin e projekteve shkollore dhe përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në këtë proces.

Besimi se çdo fëmijë ka të drejtën për arsimim dhe mundësi për një mësim cilësor është në thelb të qasjes së të drejtave të njeriut që një sistem arsimor ka. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (CRC) thekson qartë synimin për të garantuar arsim cilësor për të gjithë dhe rëndësinë e ofrimit të mbështetjes së nevojshme gjithëpërfshirëse për zhvillimin e potencialit të çdo fëmije. Arsimimi cilësor mund të arrihet vetëm kur çdo fëmijë, përfshirë më të marginalizuarit dhe të përjashtuarit, është i përfshirë në vendimmarrjen në shkollë, dhe kur të gjitha veprimet konkrete të ndërmarra në shkollë u japin atyre aftësitë e nevojshme për jetën.

Përmes këtij moduli, stafi i institucioneve arsimore dhe hartuesit e projekt-propozimeve do të kenë mundësinë:

- Të njihen me hapat e nevojshëm për hartimin e një projekt-propozimi cilësor;
- Të zhvillojnë aftësitë për identifikimin e problemit dhe analizimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm;
- Të informohen për burime të ndryshme financimi dhe mënyrat se si t'i kërkojnë ato;
- Të kuptojnë rëndësinë e një partneriteti efektiv dhe rolin që ai luan në suksesin e projekt-propozimit;
- Të mësojnë mbi elementët e një projekt-propozimi dhe mbi teknikat për zhvillimin e tyre;
- Të ndërtojnë me sukses Matricën e Kornizës Logjike të projektit;
- Të njihen me këshilla praktike që përmirësojnë cilësinë e projekt-propozimit;
- Të rrisin kapacitetet për të shkruar një projekt zhvillimi cilësor

I. HARTIMI I PROJEKTIT

FAZA PËRGATITORE – ANALIZA E SITUATËS

Çdo projekt nis me një ide. Kjo ide mund të vijë nga ju si pjesë e stafit të shkollës ose nga një nevojë e identifikuar nga një individ apo grup brenda shkollës. Për të hartuar një projekt-propozim të suksesshëm, është thelbësore të keni një ide të qartë mbi të cilën do të bazoni projektin.

Për këtë qëllim, përpara se të ndërmerrni hapat e tjerë, duhet të reflektoni dhe të kryeni një analizë të situatës aktuale lidhur me problemin që keni identifikuar. Kjo analizë është hapi i parë në ciklin e projektit dhe është thelbësore për t'u ndërmarrë përpara se të vendosni mbi hartimin dhe strategjinë e projektit që do të ndiqni.

Më poshtë paraqitet një listë pyetjesh që përfshin komponentët kryesorë të kësaj faze dhe që do t'ju ndihmojnë të analizoni and qartësoni idenë tuaj. Duke menduar në mënyrë kritike rreth këtyre pyetjeve, do të ndërtoni themele të forta për projekt-propozimin tuaj.

1. Identifikimi i problemit:

Diagnoza fillestare është pikërisht ajo e identifikimit të problemit. Disa nga pyetjet kryesore që duhet të parashtrihen në këtë fazë janë:

- Cili është problemi apo situata që projekti synon të adresojë?
- A ka fakte apo të dhëna që mbështesin ekzistencën dhe seriozitetin e problemit?
- Kush është i prekur nga problemi?
- Cilat janë kushtet ose rrethanat që kontribuojnë në shfaqjen e problemit?
- Cilat janë pasojat e problemit?
- Sa i rëndësishëm është ky problem?
- Pse është e nevojshme kjo iniciativë? Pse duhet të adresohet?
- Çfarë nevojash të rëndësishme po përpiqeni të plotësoni?

Gjatë analizimit të problemit, është e rëndësishme të mbani parasysh se një problem është mjaftueshëm i rëndësishëm dhe tërheq vëmendjen e donatorëve kur:

- Përbën shqetësim për nxënësit, prindërit dhe mësuesit
- Është konkret dhe i demonstrueshëm
- Është i zgjidhshëm
- Është emergjent dhe përbën prioritet

2. Vendosja e objektivave të qarta

Hapi i dytë thelbësor në hartimin e një projekti është përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave të qarta që projekti synon të arrijë. Duke pasur objektiva të qarta, aktivitetet dhe burimet mund të fokusohen në mënyrë efektive për të arritur rezultatet e dëshiruara. Kjo gjithashtu ndihmon në lehtësimin e planifikimit dhe menaxhimit të projektit, si dhe në matjen e suksesit të tij. Disa nga pyetjet që ndihmojnë në vendosjen e objektivave janë:

- Cilat janë objektivat specifike të projektit?
- Cilat janë rezultatet dhe përfitimet e pritshme të projektit?
- Si do të kontribuojë projekti në zgjidhjen e problemit të identifikuar?

3. Palët e interesuara dhe përfituesit

Grupi i synuar janë pikërisht ata të cilët janë të prekur më së shumti nga ky problem dhe ata që do përfitojnë nga implementimi i projektit.

Në analizën që do bëni për grupin tuaj të synuar, mbani në vëmendje se kemi dy lloje përfituesish: përfitues të drejtëpërdrejtë (direkt) dhe përfitues jo të drejtëpërdrejtë (indirekt).

- *Përfituesit e drejtëpërdrejtë* janë përfituesit kryesorë që dëshironi të synoni/mbështetni direkt me aktivitetet e projektit tuaj dhe për të cilët doni të arrini një efekt, rezultat.
- *Përfituesit jo të drejtëpërdrejtë* përfshijnë njerëzit në mjedisin e përgjithshëm. Për shkak se ata luajnë një rol të rëndësishëm ndërmjetës, grupet e synuara indirekte duhet gjithmonë të merren në konsideratë.

Bëni një listë të personave që synoni të influenconi me këtë iniciativë. Renditini sipas radhës nga ata që mendoni se janë grupi i synuar kryesor deri tek ata më pak të influencuar. Për këtë referojuni pyetjeve të mëposhtme:

- Kë synoni të ndihmoni me projektin tuaj? Kush do të përfitojë nga ai?
- A përmban projekti nevojat e vërteta të aktorëve të synuar?
- Si ndikon projekti tek ata?
- Në cilën fazë të projektit do të përfshihen?
- Cilat janë përfitimet për grupin e gjerë të përfituesve?

4. Mbledhja e informacionit nga mjedisi rrethues:

Mblidhni sa më shumë informacione që të mundeni rreth çështjes që ju synoni të trajtoni; Informacioni që grumbulloni duhet të jetë i vlefshëm dhe i besueshëm.

- Si fillim bëni një vështrim të detajuar mbi informacionet dhe shërbimet që po ofrohen në këtë periudhë mbi çështjet që ju kërkoni të adresoni.
- Kërkoni të dhëna nga raporte zyrtare, botime, artikuj kërkimor, raporte apo botime nga organizata të ndryshme, intervista dhe artikuj nga media të ndryshme, të dhëna që institucione të ndryshme që mund t'i kenë në arkivin e tyre etj.
- Shpërndani pyetësorë online dhe përballë. Komunikoni / bisedoni
- ballë për ballë me anëtarë të grupit tuaj të përfituesve që keni evidentuar kjo do t'ju ndihmojë të merrni reagimet e tyre në kohë reale.

5. Pritshmëritë:

Bëni një analizë të ndryshimeve që do të sjellë projekti dhe si do të kontribuojë ai në fushën e evidentuar nga ju.

- Çfarë do të ndryshojë zbatimi i këtij projekti?
- Çfarë risish sjell ky projekt?
- Çfarë ndikimi do të ketë ai në punën tuaj? A është ky projekt-ide në përputhshmëri me misionin e institucionit tuaj?

6. Këndvështrimi i donatorit:

Donatorët e mundshëm duhet të binden jo vetëm se problemi që ju parashtroni është mjaft i rëndësishëm për të merituar vëmendjen e tyre, por gjithashtu që zgjidhja e problemit është e realizueshme dhe se ju personat e duhur për ta realizuar këtë.

Analizoni pyetjet e mëposhtme:

- Pse duhet të t'ua japi juve ato para?
- Cilat janë gjërat më të rëndësishme që një donator dëshiron të dijë?
- A është projekt ideja juaj brenda kontekstit të objektivave të donatorëve? Zakonisht donatorë të ndryshëm shpallin fushat e tyre të veprimit (objektivat) tre ose më shumë vjeçare që para hapjes së thirrjeve për grante.

Krijimi i partneriteteve efektive

Partneriteti me institucione të tjera, në shumicën e rasteve, është një detyrim nga financuesi. Për këtë, duke qenë se rrugëtimi do të jetë i përbashkët, gjetja e partnerëve të duhur do të jetë thelbësore në suksesin e aplikimit dhe në zbatimin e suksesshëm të tij.

Partnerët dhe bashkëpunëtorët mirë është të jenë të vendosur në zonën gjeografike që përfshin projekti për të cilin po aplikoni. Faza e ideimit dhe hartimit të projekt propozimit mund të kërkojë një kohë të gjatë, për këtë është thelbësore që procesi i identifikimit të partnerëve për projekte të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

E rëndësishme është që partneriteti të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të gjithë partnerët të përfshihen në shkrimin e projektit propozimit (sidomos në pjesët që kanë të bëjnë me rolin e secilit partner në projekt); në ndërtimin e objektivave të përbashkëta si dhe plotësimin e formës së aplikimit. Kjo pasi projekti duhet jo vetëm të implementohet në bashkëpunim por dhe të përgatitet po në bashkëpunim duke dhënë secili partner këndvështrimet e tyre që në fillim të procesit. Secili partner ka forma të veçanta ekspertize për t'i ofruar projektit. Ata i sjellin një grup të ndryshëm vlerash, prioritetesh, burimesh dhe kompetencash në një partneritet. Kjo do të sigurojë mes të tjerash që projekt propozimi i shkruar të jetë i besueshëm dhe i qartë teknikisht

PËRGATITJA E NJË PROJEKT PROPOZIMIT

Tashmë me ide të qarta mbi atë se çfarë doni të bëni dhe çfarë rezultati doni të arrini, si dhe me një hartë të gjerë të partnerëve të mundshëm me të cilët do doni të bashkëpunoni, jeni gati t'i konkretizoni idetë tuaja në një projekt propozim të mirëfilltë.

Duhet të mbani në vëmendjen tuaj se thirrjet për propozime, përpos kritereve të tyre shumë strikte, janë të kufizuara dhe në kohë; çka do të thotë se aplikimet për projekt propozim qëndrojnë të hapura vetëm për një periudhë të caktuar kohore. Edhe pse, në pamje të parë, kjo kohë mund t'ju duket relativisht e gjatë, kur të filloni me përgatitjen e projektit, do vëreni se koha "fluturon" shumë shpejt sidomos nëse ende nuk e keni analizuar hapat e mëparshme.

Më poshtë do të gjeni disa rekomandime për t'ju orientuar përpara se të filloni procesin e shkrimit të projekt propozimit:

Këshilla para se të filloni së shkruari projekt propozimin:

- *Lexoni me kujdes të gjitha dokumentet që i janë bashkëngjitur thirrjes për*

projekt propozime.

- *Gjatë plotësimit të aplikimit ndiqni saktësisht rregullat e thirrjes.*
- *Duhet të plotësohen të gjitha pjesët e formularit të aplikimit, duke ndjekur rregullat specifike që shpjegojnë secilën pjesë.*
- *Duhet të tregoni se keni ide të qartë për projektin tuaj; dëshmoni se e dini saktësisht çka duhet bërë, si duhet dhe pse duhet bërë ashtu.*
- *Projekti duhet të jetë aq mirë i shkruar saqë të kuptohet edhe nga persona të tjerë që nuk janë në brendësi të idesë së projektit.*
- *Duhet t'i strukturoni idetë në mënyrë logjike dhe duhet ta keni të qartë se cilat rezultate dëshironi të arrini që t'ua bëni të qartë edhe të tjerëve.*
- *Respektoni numrin e faqeve të kërkuara dhe mos ndryshoni radhitjen e tyre.*

Këshilla për një tekst të qartë:

- *Teksti i projekt propozimit duhet patjetër të jetë i qartë, konciz dhe i lehtë për t'u lexuar.*
- *Mbani ton formal të shkrimit dhe përdorni fjali të shkurtra (15-20 fjalë)*
- *Përdorni paragrafë të shkurtër.*
- *Shmangni përdorimin e akronimeve; nëse është e nevojshme t'i përdorni, mos i lini pa i sqaruar.*
- *Informacioni duhet të jetë i kufizuara në atë që është esenciale për përshkrimin e projekt propozimit dhe duhet të kenë rrjedh logjike.*
- *Mos bëni gabimet gramatikore.*
- *Produkti përfundimtar duhet të jetë i njëtrajtshëm dhe homogjen.*

Gabimet tipike të shkrimit të projekteve:

- *Nuk u kushtohet vëmendje e mjaftueshme kërkesave formale të donatorit.*
- *Forma e detyrueshme e aplikimit nuk respektohet.*
- *Projekt propozimi i tejkalon aftësitë e institucionit.*
- *Projekt propozimi është i paqartë, shumë i madh ose shumë i vogël.*
- *Projekt propozimi nuk tregon lidhje të qartë me qëllimet e programit.*
- *Objektivat e projektit janë përshkruar në terma shumë të përgjithshme dhe pa asgjë konkrete.*
- *Aplikanti kërkon të “shpëtojë botën ” – propozimi duket jo real.*
- *Aplikanti jep informacione të gabuara në projekt propozim.*
- *Teksti nuk është i strukturuar qartë, mungon logjika e brendshme.*
- *Aplikanti shkruan në terma përjashtuese ose fyese.*
- *Mosrespektimi i afatit përfundimtar kohor.*

SHTJELLIMI I ELEMENTEVE TE PROJEKT PROPOZIMIT

Projektet janë unike dhe çdo donator ka formatin e tij të aplikimit për projekt propozime, për këtë arsye nuk ka një strukturë të saktë apo të vetme për ta shkruar atë dhe gjithmonë duhet të jemi të kujdesshëm t'i përshtatemi kërkesave. Zakonisht së bashku me formatin e aplikimit, aplikuesve u jepet dhe një dokument tjetër bashkëlidhur që i udhëzon ata hap pas hapi në shkrimin e projektit.

Megjithëse formatet e aplikimeve ndryshojnë nga një thirrje dhe donator në një tjetër, ka disa elemente kyçe të shkrimit të projektit që gjenden në çdo projekt propozim, pavarësisht shtesave dhe kërkesave të veçanta që mund të mbartin nga një formular aplikimi në tjetër. Ajo çfarë mund të ndryshojnë nga një aplikim në tjetër mund të jetë radhitja apo dhe terminologjia e përdorur por kryesisht thelbi mbetet i njëjtë.

Elementet e përgjithshëm të projekt-propozimit janë si më poshtë:

1. Titulli i projektit
2. Të dhënat e aplikuesit
3. Kohëzgjatja e projektit
4. Përmbledhja e projektit
5. Analiza e kontekstit/Justifikimi i projektit
6. Qëllimi dhe objektivat e projektit
7. Përfituesit e projektit/Kategoritë e përfituesve
8. Rezultatet e pritshme
9. Aktivitetet e projektit
10. Qëndrueshmëria
11. Personeli i angazhuar në projekt
12. Buxheti i detajuar (kostot fikse, pajisjet e nevojshme)

TITULLI I PROJEKTIT

Zgjidhni një titull të mirë për projektin tuaj. Ai duhet të reflektojë qëllimin e projektit; një titull që ka pak lidhje me projektin tuaj, rrezikon të duket jo profesional. Mos synoni tituj të gjatë dhe plot me zhargone, përgjithësisht titujt e gjatë të projekt propozimeve dështojnë në përpjekje për t'i dhënë lexuesit tablonë efektive të asaj që është brenda dhe rrezikojnë të mos mbahen mend. Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konciz dhe i qartë.

Rikthejuni dhe një herë titullin pas mbarimit të projekt propozimit, a reflekton ai ende ideologjinë e projektit, a e përmbledh në një fjali idenë e asaj çfarë doni të realizoni? Nëse po, atëherë ai është i duhuri.

TË DHËNAT E APLIKUESIT

Qëllimi i këtij seksioni është të japë një përshkrim të shkurtër të institucionit lider (emri i institucionit, viti i hapjes, fushat e ndërhyrjes; emrat e kontakteve kryesore, adresa si numrat e telefonit dhe adresat e e-mailit etj.). Kjo do të jetë një pasqyrë fillestare e aplikantit, pasi në vijim mund të ketë një tjetër seksion të dedikuar personelit të angazhuar në projekt.

KOHËZGJATJA E PROJEKTIT

Kohëzgjatja e projektit duhet të jetë brenda kornizave kohore të parashikuara nga donatori, gjithashtu duhet të specifikoni ditën, muajin, vitin kur do të fillojë dhe mbarojë projekti. Megjithatë për shkak të gjërave të paparashikuara apo pengesave të hasura gjatë implementimit të projektit, mund të ndodhë që projekti, me leje të donatorit dhe në bashkëpunim me partnerët, të zgjatet në kohë, por gjithsesi ju duhet të keni një datë fikse të parashikuar në projekt propozim.

PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT/JUSTIFIKIMI I PROJEKTIT

Për një thirrje për financim, aplikimet për projekte mund të jenë të shumta dhe, për shkak të efektit kohë, jo të gjitha arrihen të lexohen nga donatori deri në fund. Me një “bum” aplikimesh në duar, donatorit i duhet të jetë shumë selektues. Është pikërisht përmbledhja e projektit që e bën këtë diferencim. Përmbledhja e projektit jep një “shije” të propozimit që do të vijë. Ajo zë një vend të veçantë, në krahasim me elementët e tjerë të projekt propozimit, pasi që është kontakti i parë i donatorit me idenë e projektit, nga ku do të kuptojë nëse ideja dhe projekti juaj ja vlen të lexohet deri në fund apo jo.

Qëllimi i këtij seksioni është të përmbledh pikat kyçe të projekt propozimit si dhe të paraqesë në mënyrë përshkruese objektivat që ai mbart, metodat e zbatimit, qasjet që duhen ndërmarrë për lehtësimin e problemit të ngritur si dhe të mirat që do të vijnë nga realizimi me sukses i tij. Mbani në vëmendjen tuaj se, përmbledhja e projektit nuk mund të jetë më shumë se një faqe kështu që, ju do ju duhet të jeni shumë seleksionues në përzgjedhjen e pikave më të rëndësishme të projektit tuaj, në mënyrë që të jepni një panoramë të plotë të asaj që do bëni por njëkohësisht të mos dilni nga fokusi juaj e as të lodhni lexuesin.

Për të mbajtur një linjë koherente të informacioneve që do parashtroni në këtë seksion përmbajuni pyetjeve të mëposhtme të njohura si 5 E-të:

- *What* - **Çfarë** do të bëni?
- *Why* - **Pse** do ta bëni?
- *How* - **Si** do ta bëni këtë?

- *Who* - **Kush** do ta bëjë këtë?
- *Where* - **Ku** do të bëhet kjo?

Këshilla!

- *Kushtojini kohë dhe vëmendje të veçantë këtij seksioni pasi do të jetë mundësia juaj e parë dhe e vetme për të lënë një përshtypje të mirë tek njerëzit që mund të financojnë grantin tuaj.*
- *Është e rëndësishme që projekti të mos japi përshtypjen sikur përpiqet të "shpëtojë botën" por të japi zgjidhje konkrete dhe të jetë më këmbë në tokë.*
- *Është mirë që përmbledhja e projektit të përmbajë diçka interesante, diçka që "të kapë syrin" e donatorit menjëherë dhe ta bëjë projektin tuaj të dallohet midis shumë të tjerëve.*
- *Përmbledhja duhet të jetë e shkurtër, e strukturuar dhe pa ujëra të tepërta.*
- *Asnjëherë mos supozoni që lexuesi i përmbledhjes suaj mund të di shumë apo ndonjë gjë në lidhje me çështjen apo përjasjen që ju adresoni. Për këtë është shumë e rëndësishme që përmbledhja e projektit të shkruhet e qartë dhe e thjeshtë në mënyrë që informacioni të kuptohet nga të gjithë lexuesit, pavarësisht nga njohuritë ose ekspertiza e tyre.*
- *Disa profesionistë të shkrimit të projekteve sugjerojnë që ta lini shkrimin e përmbledhjes së projektit të fundin, pra pasi të keni përfunduar së bëri të gjithë komponentët e tjerët të projekt propozimit shkrimin e projektit.*

ANALIZA E KONTEKSTIT

Analiza e kontekstit të projektit jep një përshkrim racional të situatës në sfondin social, ekonomik, politik dhe kulturor. Është një përshkrim përmbledhës i mjedisit dhe historisë pas projektit. Fokusi primar i tij është të japë një pasqyrë të përgjithshme të problemit; sa serioz, sa i përhapur është dhe pasojat e mundshme që mund të ndodhin nëse nuk ndërmerren veprime për të kapërcyer këtë problem.

Në këtë seksion ju duhet të demonstroi që e kuptoni me të vërtetë thelbin e problemit, shkakun, pasojat dhe si mund të zgjidhet ai, gjithashtu dhe burimet e nevojshme për të arritur këtë rezultat. Pikat e mëposhtme do t'ju ndihmojnë të arrini në këtë konkluzion dhe të formuloni një analizë konteksti të suksesshme:

- Parashtrimi i problemit (*Përse po e bëni këtë projekt?*)
- Historia e problemit (*Problemi duhet të jetë real dhe jo një problem imagjinar*)
- A është projekti një nxitje e një ngjarje apo çështje specifike?
- A është ky projekt në vazhdimësi të hulumtimeve të mëparshme të kryera nga ju apo dikush tjetër apo është një projekt hulumtimi "i parë i llojit të tij"?

- Çfarë hulumtimi keni bërë për të mësuar rreth zgjidhjeve të mundshme?
- Numri i përafërt i njerëzve që janë të prekur drejtpërdrejt ose indirekt nga ky problem.
- Hapat e ardhshëm që nevojiten të ndërmerren si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe atë afatgjatë.

Këshilla!

- *Është e rëndësishme që të mos hallakateni gjatë shpjegimit, nga sfera më e përgjithshme duhet të fokusoheni në rajonin gjeografik ku ju shërbeni. Ju duhet të demonstroi që e njihni shumë mirë kontekstin lokal.*
- *Përkthyeri një problem specifik, të cilin përpiqet ta zgjidhë projekti, për t'i dhënë këtij të fundit arsye apo kuptim.*
- *Duhet të godisni në shenjë, pa u humbur në detaje të panevojshme të cilat mund të çojnë në humbjen e interesit të donatorit-lexues.*
- *Përdorni ekspertizën tuaj për ta shpjeguar atë, por e bëni të thjeshtë për ta kuptuar.*
- *Parashtroni nevojat duke përdorur statistikat bindëse që mbështesin argumentin tuaj.*
- *Bëni një përmbledhje të shkurtër të mësimave të nxjerra nga eksperiencat e mëparshme me projekte të ngjashme apo paraqitni histori të vërteta si shembuj.*
- *Ky seksion nuk duhet të jetë më shumë se një faqe.*
- *Nëse është e nevojshme përfshini referenca në dokumentacionin mbështetës, siç janë dokumentet dhe artikujt e hulumtimit.*

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Shpesh në botën e projekteve, por dhe në fusha të tjera, flasim për qëllime dhe objektiva të cilat duam/kërkojmë të arrijmë. Por çfarë janë qëllimet dhe çfarë janë objektivat? Shpesh, pa u kushtuar vëmendjen e duhur, i përdorim këto terma në mënyrë të ndërsjellë duke i ngatërruar me njëra-tjetrën - por a janë të njëjta? Thuhet se qëllimet pa objektiva nuk mund të arrihen kurrë, ndërsa objektivat pa qëllime nuk do të arrinin rezultatin që do të donin. Në të vërtetë të dy konceptet janë të lidhura me njëra-tjetrën por dhe të ndara. Të dyja përcaktojnë dhe përshkruajnë atë çfarë institucioni me projekt propozimin dëshiron të arrijë por ajo çfarë i diferencon nga njëra-tjetra është afati kohor, atributet që vendosin dhe efekti që bëjnë.

Qëllimi, ose siç mund ta hasni dhe ndryshe – Objektivi i Përgjithshëm, shpjegon thelbin e problemit dhe rëndësinë e projektit; ai është rezultati afatgjatë që ju nëpërmjet projektit tuaj dëshironi apo keni nevojë për të arritur.

Objektivat janë rezultatet e verifikueshme të projektit. Ato janë hapat që ju do të ndërmerrni për të arritur qëllimin tuaj dhe japin një përshkallëzim më të detajuar të tij.

Në tabelat e mëposhtme ju do të gjeni të pasqyruar dallimet midis qëllimit dhe objektivave dhe njëkohësisht karakteristikat përkatëse për t'i ndërtuar ato në mënyrë sa më të saktë.

QËLLIMI	OBJEKTIVAT
<ul style="list-style-type: none">▪ Projekti ka 1 (një) qëllim kryesor, i cili zbërthehet në disa objektiva të ndryshëm	<ul style="list-style-type: none">▪ Projekti duhet të ketë disa objektiva që japin një përshkallëzim më të detajuar të qëllimit të projektit
<ul style="list-style-type: none">▪ Qëllimi është një përshkrim i një destinacioni	<ul style="list-style-type: none">▪ Objektivat janë hapat që nevojiten për të arritur në destinacion
<ul style="list-style-type: none">▪ Qëllimi është afatgjatë dhe nuk mund të arrihet vetëm me një ose disa projekte	<ul style="list-style-type: none">▪ Objektivat realizohen në afat të shkurtër apo të mesëm brenda afatit kohor të projektit
<ul style="list-style-type: none">▪ Qëllimet është vizionar, bazohen në ide	<ul style="list-style-type: none">▪ Objektivat bazohen në fakte
<ul style="list-style-type: none">▪ Qëllimet janë shpesh të hapura dhe të▪ pa strukturuara në natyrë	<ul style="list-style-type: none">▪ Objektivat janë konkrete dhe direkte

▪ Qëllimet janë të vështira për t'u vendosur një afat kohor	▪ Objektivat duhet t'u jepen një afat kohor për të qenë më efektiv
▪ Qëllimi është shumë i gjerë dhe jo i prekshëm (jo i matshëm)	▪ Suksesi i një objektivi mund të matet me lehtësi

Mendoni në mënyrë të “zgjuar” kur ndërtoni objektivat tuaj, pasi që ato duhet të jenë SMART:

- ***Specific*** – (Specifike): Ato duhet të plotësojnë nevojat (problemet) të identifikuar dhe çdo progres drejt objektivit t'i atribuohet projektit dhe jo ndonjë arsye tjetër
- ***Measurable*** – (Të matshme): Ato duhet të maten me tregues konkretë, të cilët duhet të pasqyrojnë shkallën deri në arritjen e tyre në mënyrë që të matet performanca e projektit.
- ***Achievable*** – (Të arritshme): Ato duhet të arrihen brenda burimeve financiare dhe fizike të dhëna dhe brenda kornizave kohore të parashikuara
- ***Realistic***– (Realiste): Objektivat duhet të bazohen në fakte
- ***Time based***- (Të arritura në kohë) Objektivat duhet të arrihen/realizohen në fund të projektit.

SHEMBULL!

Qëllimi i përgjithshëm: “Të rritet cilësia e edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në ciklin fillor të arsimit bazë”

Qëllimi i përgjithshëm është në thelb e kundërta e problemit kryesor të evidentuar në fazën e parë të identifikimit të situatës. Kështu, nëse supozojmë se për shembullin konkret problemi kryesor do të ishte cilësia e dobët e edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në ciklin fillor (problemi i përgjithshëm), atëherë ju me projektin tuaj do të kontribuoni në rritjen e cilësisë të këtij lloji edukimi në shkollën tuaj (qëllimi i përgjithshëm).

Siç vërejmë, ky qëllim është i përgjithshëm, vizionar dhe afatgjatë, çka do të thotë se mund të zgjasë disa kohë apo vite për t'u arritur, pra do të ndodhi një ditë në të ardhmen, por nuk e dimë saktë kur do të vijë koha.

Objektivat:

1. Të përmirësohet infrastruktura e institucionit përmes ndërtimit të një klase burimore ku mësojnë fëmijët me nevoja të veçanta;
2. Të ndërtohen protokolle të mësuesit ndihmës dhe mësuesit të klasës për mbajtjen e arritjeve dhe përparimit të fëmijës me nevoja të veçanta

Përmbushja e Objektivit 1 dhe 2 kontribuon në arritjen e qëllimit të

përgjithshëm të projektit.

Objektivat janë problematikat e hasura të konvertuara në synime për t'i arritur, pra konvertimi nga aspektet negative (problematikat) në ato pozitive (objektivat). Pra nëse keni evidentuar se cilësia e dobët e edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta (problemi i përgjithshëm), ndër shumë të tjerave, vjen si pasojë edhe e infrastrukturës jo të përshtatshme në institucionin arsimor (problemi 1), atëherë ju do të ndërhyni nëpërmjet projektit tuaj për të përmirësuar infrastrukturën (objektivi 1).

Nëse gjithashtu keni evidentuar se cilësia e dobët e edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta (problemi i përgjithshëm) vjen si pasojë edhe e mungesës së protokolle të mësuesit ndihmës dhe mësuesit të klasës për mbajtjen e arritjeve dhe përparimit të fëmijës (problemi 2), atëherë ju do të punoni për ti hartuar këto protokolle (objektivi 2).

Pra, realizimi me sukses i këtyre dy objektivave do të çojnë/kontribuojnë në përmbushjen e qëllimit të përgjithshëm të projektit.

PËRFITUESIT

Këtu bëhet lidhja me njerëzit që do të përfitojnë nga projekti juaj dhe si ky target grup do të përfitojnë nga zgjidhja e këtij problemi.

Kujt i adresohet projekti? Në këtë pjesë përshkruani në mënyrë sasiore (me numra) përfituesit që prisni nga projekti juaj – sa fëmijë, të rinj, të rritur, prindër, dhe kategori të tjera shoqërore do të përfitojnë nga zbatimi i këtij projekti. Kur është e mundur, ju përshkruani karakteristikat e grupit të përmendur. (Për shembull, 4 fëmijë me nevoja të veçanta, të grupmoshës 7-11 vjeç).

REZULTATET E PRITSHME

Mendoni për rezultatet që prisni në përfundim të projektit. Ato e bëjnë më konkret qëllimin e projektit. Kthehuni përsëri tek seksioni i përshkrimit të projektit, qëllimit dhe objektivave dhe hartoni rezultatet e pritshme për çdo objektivi të projektit tuaj. Kjo formon bazën mbi të cilën do të vlerësohet projekti. Ju lutem mbani në vëmendjen tuaj se rezultatet duhet të jenë specifike, konkrete dhe praktike.

Rezultatet e projektit janë ato rezultate që arrihen menjëherë pas zbatimit të një aktiviteti. Për shembull, nëse po organizojmë një trajnim për klasën burimore, pjesëmarrësit që morën pjesë në këtë seminar, tani kanë një kuptim më të qartë mbi atë se në çfarë përmban kjo klasë dhe si punohet në të me

fëmijën me nevoja të veçanta. Pra, ky është një produkt që projekti ka arritur dhe arrihet menjëherë pas përfundimit të trajnimit.

SHEMBULL!

Duke iu referuar shembullit bazë të këtij moduli, në vijimësi të lidhjes logjike të shpjeguar më sipër, ku realizimi i objektivave të projektit çojnë/kontribuojnë në përmbushjen e qëllimit të përgjithshëm të tij, në këtë fazë do të kuptojmë sesi realizimi i rezultateve konkrete do të çojnë në përmbushjen e objektivave përkatëse.

Në vijim të shembullit:

Objektivat:

1. Të përmirësohet infrastruktura e institucionit përmes ndërtimit të një klase burimore ku mësojnë fëmijët me nevoja të veçanta;
2. Të ndërtohen protokolle të mësuesit ndihmës dhe mësuesit të klasës për mbajtjen e arritjeve dhe përparimit të fëmijës me nevoja të veçanta.

Rezultatet:

- 1.1. Një klasë burimore e pajisur tashmë funksionon në shkollë;
- 2.1. 2 formate protokolle që regjistrojnë përparimin e fëmijës të hartuara dhe të përdorura nga mësuesi i klasës dhe mësuesi ndihmës

Përmbushja e Rezultatit 1.1 çon në realizimin e Objektivit 1

Përmbushja e Rezultatit 2.1 çon në realizimin e Objektivit 2

AKTIVITETET E PROJEKTIT

Pas hartimit të qëllimit dhe objektivave të projekt propozimit tuaj, ju duhet ti konkretizoni ato nëpërmjet hartimit të listës së aktiviteteve. Aktivitetet janë hapat konkrete që duhen të ndërmerren për arritjen e objektivave të projektit dhe rrjedhimit realizimin e suksesshëm të tij.

Gjatë përcaktimit të aktiviteteve të projekt propozimit tuaj mbani në konsideratë që:

- Aktivitetet të jenë në një lidhje logjike me objektivat duke shpjeguar sesi do të arrihet secilit objektiv. Çdo objektiv i projektit duhet të ketë një ose më shumë aktivitete që i korrespondon dhe mundëson arritjen e tij.
- Duhet të jepet një përshkrim i qartë i aktiviteteve, grupit të synuar të secilit, rrjedha e tyre dhe përcaktimi i stafit/partnerit/ ekspertëve të cilët do të punojnë në realizimin e tyre.
- Aktivitetet kërkojnë një sërë komponentësh për t'u realizuar, kështu që gjatë hartimit të tyre mendoni dhe për burimet e disponueshme

njerëzore, fizike dhe financiare që do ju nevojiten.

- Vendosni kohën e fillimit, kohëzgjatjen dhe përfundimin e çdo aktiviteti dhe detyre. Aktivitetet duhet të realizohen brenda periudhës së përcaktuar të implementimit të projektit.

SHEMBULL!

Në këtë seksion do të kishim këtë ndërlidhje logjike: Realizimi i aktiviteteve do të sillte rezultatet përkatëse konkrete; arritja e rezultateve konkrete do të çonte në përmbushjen e objektivave përkatëse dhe realizimi i objektivave të projektit çojnë/kontribuojnë në përmbushjen e qëllimit të përgjithshëm të tij.

Në vijim të shembullit bazë të këtij manuali:

Rezultatet:

- 1.1. Një klasë burimore e pajisur tashmë funksionon në shkollë;
- 2.1. 2 formate protokollesh që regjistrojnë përparimin e fëmijës të hartuara dhe të përdorura nga mësuesi i klasës dhe mësuesi ndihmës

Aktivitetet:

- 1.1.1 Përcaktimi i klasës burimore në shkollë
- 1.1.2 Pajisja e klasës me bazën materiale të nevojshme
- 2.1.1 Trajnimi i mësuesve ndihmës dhe mësuesve të klasës
- 2.1.2 Hartimi i formateve të dokumenteve që mbajnë përparimin e fëmijës

Realizimi i Aktiviteteve 1.1.1 dhe 1.1.2 çojnë në arritjen e Rezultatit 1.1

Realizimi i Aktiviteteve 2.1.1; 2.1.2 çojnë në arritjen e Rezultatit 2.1

KALENDARI I AKTIVITETEVE

Pas identifikimit të aktiviteteve të projekt propozimit tuaj, do ju duhet të përcaktoni kohën e implementimit të tyre si dhe personat /partnerët përgjegjës për realizimin e tyre. Këto të dhëna pasqyrohen vizualisht në kalendarin e aktiviteteve të projekt propozimit.

Në këtë fazë aplikantët nuk duhet të japin një datë specifike fillestare për zbatimin e aktivitetit, por thjesht i referohen 'muajit 1', 'muajit 2' etj i realizimit të aktivitetit.

Shembull i kalendarit të aktiviteteve të projektit:

	Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Përgjegjës për implementimin
Aktiviteti 1		■	■											Partneri kryesor
Aktiviteti 2			■	■	■									Parteri 1
Aktiviteti 3				■	■	■	■							Parteri 2
Aktiviteti 4							■	■	■	■				Parteri 3
Aktiviteti 5											■	■	■	Partneri kryesor

QËNDRUESHMËRIA E PROJEKTIT

Efekti i projektit duhet të vazhdojë edhe pas implementimit të tij, pasi ashtu siç shpjeguam dhe më sipër, arritja e qëllimit është në proces afatgjatë. Shumica e donatorëve, edhe pse ofrojnë burimet financiare të parashikuara vetëm për periudhën e implementimit të projektit, i kushtojnë shumë rëndësi vazhdimësisë së tij. Kjo për shkak se donatorët duan të jenë të sigurt se investimi i tyre nuk do të humbasë në fund të projektit por efekti i tij do të vazhdojë për një kohë të gjatë edhe pas realizimit të tij. Ai kërkon nga ju që të planifikoni që tani një strategji për vazhdimësinë e projektit edhe pas mbarimit të burimeve aktualisht të disponueshme.

Për këtë, implementuesit e projektit u kërkohet:

- Të japin shpjegime për burime financiare të përfituara në të kaluarën apo aktuale, produktet e të cilave mund të kombinohet apo të vihen në dispozicion të këtij projekti dhe të bashkëpunojnë për vazhdimësinë e tij.
- Të gjejnë burime të tjera financimi nga donator të tjerë apo qoftë dhe nga burimet e tyre të nevojshme që projekti të vazhdojë të ekzistojë edhe në të ardhmen.
- Të japin shpjegim mbi sesa gjasa (siguri) ka që burimet e sipërpërmendura do të vazhdojnë të mbështesin projektin financiarisht
- Sigurohuni që të përmendni kontributet në natyrë, të tilla si punë vullnetare, qera ambienti, pajisje në përdorim të institucionit tuaj etj të cilat mund të vihen në dispozicion të projektit.

Ju mund të jepni informacion më të detajuar sidomos kur keni të bëni me një donator me të cilin nuk keni bashkëpunuar në të shkuarën, duke shtuar/bashkëlidhur në shtojcat (anekset) e projekt propozimit tuaj broshura prezantimi të projekteve, historinë, burime të tjera financiare të përfituara në të shkuarën (listë e donatorëve) dhe investimet e rëndësishme në të shkuarën që keni bërë ju si institucion lider dhe partnerët tuaj të përfshirë në projekt.

BUXHETI I DETAJUAR

Buxheti është shprehja e projektit në vlera monetare. Ai ndryshon nga një thirrje te tjetra. Kjo varet dhe nga madhësia e projektit për të cilin po aplikohet; Projektet e vegjël që zgjasin pak muaj kërkojnë burime financiare modeste, ndërsa një projekt i madh mund të kërkojë shuma të mëdha dhe të zgjasë për shumë vite. Buxheti përfshin të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe të lejueshme që nevojiten për të realizuar projektin në kohë.

Mbani në vëmendje se zakonisht për financim të jashtëm, si rregull i përgjithshëm, kërkohet bashkëfinancim nga përfituesit e tij, me vlerën 15% të buxhetit total të projekt propozimit. Ky 15% mund të financohet nga burimet e përfituesit ose partnerëve apo nga fonde të tjera ose mund të shlyhet nëpërmjet “kontributit në natyrë” duke përfshirë këtu punë vullnetare, pajisje nga projektet e mëparshme, hapësirë pune etj.).

Këshilla!

- Buxheti duhet të jetë nga poshtë - lart dhe jo nga lart - poshtë (shuma e përmbledhur nuk duhet të specifikohet që në fillim dhe pastaj ato shpenzimet individuale specifike, por duhet të filloj me aktivitetet specifike, shpenzimet, pajisjet që nevojiten etj. për të arritur pastaj në një shumë finale
- Duhet të jenë shumë mirë të specifikuara dhe jo mbi vlerësime të përafërta
- Ai duhet të jetë i qartë dhe i lexueshme (shuma finale, shuma për zë, shpenzime specifike)
- Linjat e buxhetit duhet të përbëjnë një rrjedhë logjike të metodës së punës dhe veprimtarive si dhe t'u përgjigjen aktiviteteve reale të projektit
- Buxheti duhet të jetë realist dhe mos të japi përshtypje si i fryrë artificialisht.

VERIFIKIMET E FUNDIT!

- Jepuni kohë vetes për të marrë reagime dhe opinione nga kolegë, miq tuaj gjatë kohës që jeni duke shkruar projektin. Sigurohuni që të lini vetes kohë për rishikime dhe për të bërë ndryshime të mundshme.
- Kontrolloni afatin për paraqitjen e propozimit. Nëse vonoheni qoftë edhe një minutë pas afatit përfundimtar propozimi juaj do të refuzohet me siguri.
- Përfshini shtojcat e kërkuara nga donatori.
- Sigurohuni që i gjithë dokumentacioni mbështetës që ka të bëjë me institucionin tuaj dhe ato partnere të përgatitet në kohë dhe të arrini ta dorëzoni propozimin në adresën e dhënë në mënyrë që të plotësohen kërkesat e donatorit.
- Kontrolloni me kujdes numrin e kopjeve të printuara, nëse janë të gjitha me firmë (aty ku kërkohet) para se ta dërgoni me poshtë.

II. SHEMBUJ PROJEKTESH TË SHKOLLËS

Shkolla 9 vjeçare “Sulë Misiri”, Elbasan

Titulli i Projektit: “Ndërtimi i një klase burimore në ndihmë të fëmijëve me aftësi të kufizuar”.

Një Përmbledhje e Shkurtër

Projekti “Ndërtimi i një klase burimore në ndihmë të fëmijëve me aftësi të kufizuar” i zbatuar në shkollën tonë gjatë periudhës shtator 2023-qershor 2024 ka shërbyer si një frymëzim i rëndësishëm për të gjithë komunitetin shkollor dhe për një arsimim sa më gjithëpërfshirës. Krijimi i klasës burimore me të gjitha mjetet didaktike të nevojshme i ka ardhur në ndihmë mësuesve për realizimin e veprimtarive mësimore edhe me nxënësit me aftësi ndryshe. Shkolla jonë është një institucion i vendosur në një zonë me komunitet të vështirë, e cila frekuentohet nga rreth 200 nxënës, ndër të cilët ka edhe nxënës që paraqesin vështirësi në të nxënë dhe me aftësi të kufizuar. Ndërtimi i klasës burimore ka qenë tepër efikas dhe e vlefshme, ka ardhur shumë në ndihmë në edukimin dhe zhvillimin e tyre. Kjo klasë burimore është shfrytëzuar shumë nga mësuesit ndihmës, punonjësi social dhe mësuesit e tjerë që mbështesin nëntë nënës me aftësi të kufizuar në shkollë.

Kjo ka dhënë një kontribut në mirë në zhvillimin e potencialit të tyre fizik, emocional, akademik, si dhe në aftësimin për jetën.

Ky projekt ka qenë një përpjekje e përbashkët për të siguruar që të gjithë nxënësit tanë të kenë qasje të barabartë në arsim dhe të ndjehen të përfshirë në procesin mësimor. Me përkushtimin e stafit pedagogjik dhe mbështetjen e aktorëve të shkollës, projekti ka arritur suksese të konsiderueshme. Nëpërmjet përdorimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe miqësore kemi arritur të rrisim angazhimin dhe performancën e nxënësve tanë. Rezultatet pozitive kanë përfshirë përmirësimin e rezultateve akademike, rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të individëve me aftësi të kufizuara, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe tolerancës në mes të nxënësve me veçori dhe përvoja të ndryshme. Kjo përvojë e krijuar përmes zbatimit të projektit është bërë një model i frytshëm për të promovuar diversitetin dhe për të ndërtuar një mjedis shkollor të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë nxënësve tanë.

Ekipi i stafit pedagogjik që mundësoi zhvillimin e projektit

Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me nëndrejtorin, mësues të tjerë të shkollës, përfaqësues nga qeveria e nxënësve dhe partnerin tonë Save the children dhanë kontributin e tyre dhe bënë të mundur realizimin me sukses të

projektit në fjalë duke i ardhur në ndihmë nxënësve me AK dhe të gjithë nxënësve e komunitetit të shkollës sonë duke promovuar diversitetin dhe gjithëpërfshirje.

Përparësitë dhe Sfidat

Realizimi i këtij projekti u ka dhënë përparësi të gjithë mësuesve dhe nxënësve të cilës e përdorin klasën burimore për të realizuar procesin mësimor, aktivitete dhe për të përballuar sfidat e ditës që dalin shpeshherë gjatë ditës. Sfidë kryesore mund të përmendim kryesisht pamundësinë e qëndrimit të nxënësit me aftësi ndryshe në klasë. Klasën burimore e kemi parë si zgjidhje pasi edhe vetë nxënësit e pëlqejnë dhe argëtohen sipas mundësive që kërkojnë. Në këtë mënyrë kemi rritur motivimin dhe interesin e nxënësve për mësim. Kur nxënësit janë të përfshirë në një mjedis të specializuar dhe të përmbushur me mjete të avancuara, atyre u jepet më shumë mundësi të zhvillojnë dashurinë dhe pasionin për fushën e tyre të zgjedhur. Shpeshherë u pëlqejnë të ngjyrosin e pikturojnë sipas imagjinatës së tyre, luajnë e formojnë me pazëlla etj. Ky projekt ka ndikuar pozitivisht në performancën e tyre akademike dhe ka sjell rezultate të mira në mënyrë të përgjithshme.

Strategjitë dhe taktikat

Me përkushtimin e stafit pedagogjik dhe mbështetjen e aktorëve të shkollës, projekti ka arritur suksese të konsiderueshme. Nëpërmjet përdorimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe miqësore kemi arritur të rrisim angazhimin dhe performancën e nxënësve tanë. Rezultatet pozitive kanë përfshirë përmirësimin e rezultateve akademike, rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të individëve me aftësi të kufizuara, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe tolerancës në mes të nxënësve me veçori dhe përvoja të ndryshme. Kjo përvojë e krijuar përmes zbatimit të projektit është bërë një model i frytshëm për të promovuar diversitetin dhe për të ndërtuar një mjedis shkollor të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë nxënësve tanë.

Arritjet dhe Sukseset Kryesore

Me mbështetjen e partnerit tonë Save the children, u bë e mundur realizimi dhe kompletimi me bazë materiale didaktike të klasës burimore në shkollë tonë. Realizimi i projektit ka qenë një ndër arritjet më efikase për shkollën dhe komunitetin që përfaqësojmë. Tashmë kjo klasë ofron kushte komode për lehtësimin e procesit mësimor për nxënësit me nevojë të veçanta, si dhe për realizimin e planit mësimor për mësuesit ndihmës dhe mësuesit e tjerë që e përdorin.

Ndër sukseset kryesore mund të përmendim:

- Diversiteti dhe arsimi gjithëpërfshirës.

- Krijimi i një ambienti argëtues, miqësor dhe gjithëpërfshirës.
- Mbështetja e edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar përmes krijimit të mjediseve të nevojshme në institucionin arsimor për të zhvilluar aftësitë motorike, emocionale dhe akademike.
- Dëshira dhe këmbëngulja e nxënësve për të punuar e argëtuar në klasën burimore, për ti realizuar aty detyrat e dhëna.

Mësimet e Nxjerra dhe Rekomandimet

Kjo klasë i ka shërbyer jo vetë 9 nxënësve me aftësi ndryshe në shkollën tonë, por edhe komunitetit dhe prindërve të nxënësve.

Ofron mjedis të qetë dhe shumë komod me mjetet e nevojshme didaktike dhe argëtues.

Ka qenë ndihmë për mësues, mësues ndihmës, nxënës, punonjës social dhe prindër.

Përfundimi

- Krijimi i klasës burimore ka transmetuar motivim dhe nxitje për realizimin sa më të mirë të sjelljeve dhe planeve mësimore, sipas aftësive të nxënësve gjatë këtij viti shkollor. Ky projekt ka bërë të mundur që shpeshherë nxënësit të shkojnë me shumë dëshirë në shkollë, ka nxjerr në pah aftësi të veçanta të nxënësve në pikturë, në realizimin e punëve motorike fine me plastelinë, në komunikimin sa më të lirshëm dhe në bashkëpunimin e bashkëveprimin në grupe të vogla.
- Mësuesit e kanë patur më të lehtë realizimin e orës mësimore në momentet e kur nxënësi ka qenë i acaruar dhe përballimin sa më të lehtë të sjelljeve stereotipike dhe më tej. Menaxhimi i situatave të veçanta ka qenë i përballueshëm.
- Nxënësit kanë transmetuar energji pozitive duke bashkëpunuar me shokë në grupe të vogla, duke u ndjerë disi lider dhe duke realizuar detyrat e kërkuara.
- Klasa burimore ofron një mjedis të këndshëm për të mësuar, duke qenë e pajisur materialet e rëndësishme didaktike dhe argëtuese.

FOTO TË VEPRIMTARIVE



Shkolla 9 vjeçare “Ali Xhetani”, Mat

Titulli i Projektit: *JO, bullizmit, PO, lumturisë së fëmijëve*

Projekti “JO Bullizmit, PO lumturisë së fëmijëve” i zbatuar në shkollën tonë për nxitjen e arsimit gjithëpërfshirës ka shërbyer si një frymëzim i rëndësishëm për të gjithë komunitetin shkollor.

Ky projekt ka qenë një përpjekje e përbashkët për të siguruar që të gjithë nxënësit tanë të kenë qasje të barabartë në arsim dhe të ndjehen të përfshirë në procesin mësimor. Me përkushtimin e stafit pedagogjik dhe mbështetjen e aktorëve të shkollës, projekti ka arritur suksese të konsiderueshme. Nëpërmjet përdorimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe miqësore kemi arritur të rrisim angazhimin dhe performancën e nxënësve tanë. Rezultatet pozitive kanë përfshirë përmirësimin e rezultateve akademike, rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të individëve me aftësi të kufizuara, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe tolerancës në mes të nxënësve me veçori dhe përvoja të ndryshme. Kjo përvojë e krijuar përmes zbatimit të projektit është bërë një model i frytshëm për të promovuar diversitetin dhe për të ndërtuar një mjedis shkollor të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë nxënësve tanë.

Një Përmbledhje e Shkurtër

Nisma për t'i thënë "Jo" bullizmit kishte për qëllim të krijonte një mjedis shkollor të sigurt për të gjithë nxënësit. Arsyet që ne kishim ndërmarrë pikërisht këtë nisme ishin këto:

- Ndërgjegjësimi dhe edukimi rreth bullizmit në shkollë dhe në shoqëri.
- Krijimi i një mjedisi shkollor të sigurtë dhe mbështetës për nxënësit.
- Ndihma dhe mbështetja për viktimat e bullizmit .
- Ndryshimi i sjelljeve dhe kulturës shoqërore për të promovuar respektin dhe mirëkuptimin.

Projekti u shtri në një periudhë 3 - mujore me aktivitete të ndryshme për çdo muaj duke angazhuar qeverinë e nxënësve, prindër, mësues të SHQK dhe psikologjen e shkollës.

Ekipi i stafit pedagogjik që mundësoi zhvillimin e projektit dhe kontributi i tyre

Ekipi i stafit pedagogjik që punoi për të promovuar lumturinë e fëmijëve dhe për të luftuar bullizmin ishte një forcë e rëndësishme për të krijuar një ambient shkollor pozitiv dhe mbështetës.

Qeveria e nxënësve: Koordinator i qeverisë së nxënësve kordinoi përpjekjet e të gjithë ekipit për të siguruar që strategjitë dhe aktivitetet për të promovuar lumturinë dhe për të luftuar bullizmin të jenë të koordinuara dhe në mënyrë sa më efektive.

Psikologja e shkollës: Ajo ofroi këshilla dhe mbështetje për trajtimin e rasteve të bullizmit, si dhe punoi në strategji për të promovuar mirëqenien emocionale dhe lumturinë nëpërmjet pyetësorëve ,bisedave me nxënës, prindër dhe mësues.

Mësues të SHQK: U krijua bashkëpunimi me mësuesit e klubit të letrareve dhe klubit të sportit. Klubi i letrarëve shpesh organizuan mbledhje të rregullta ku anëtarët diskutuan libra të caktuar me këtë tematikë, përcollën mesazhe si dhe promovuan vlera. Klubi i sportit pati një rol të rëndësishëm në promovimin e shëndetit dhe mirëqenies fizike, si dhe në ndërtimin e karakterit dhe aftësive.

Përparësitë dhe Sfidat që ju përballuat

Identifikimi i përparësive dhe sfidave në zhvillimin e një projekti është një pjesë e rëndësishme e procesit të menaxhimit të projektit.

Përparësitë:

- Burimet dhe mjetet e mjaftueshme: Për të filluar projektin, disponimi i burimeve dhe mjeteve ishin të mjaftueshme. Save the children ka vënë në dispozicion të gjitha mjetet e duhura për zhvillimin me sukses të projektit
- Planifikimi i mirë: Planifikimi i mirë dhe hartimi i një plani të qartë ishte një përparësi që ndihmoi në koordinimin e veprimeve dhe në minimizimin e shqetësimeve të mundshme gjatë zhvillimit të projektit.
- Angazhimi i nxënësve: Nxënësit u treguan të gatshëm për të dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e projektit.

Sfidat:

- Kufizimet e kohës: Koha është një sfidë e rëndësishme. Për shembull, nëse ka një afat të caktuar për përfundimin e projektit, duhet të sigurohet që të gjitha detyrat të plotësohen brenda këtij afati.
- Angazhimi i mësuesve dhe nxënësve me mbledhje pune, trajnime ose konkurse gjatë periudhës së projektit.

Strategjitë dhe taktikat që përdorët

Këtu janë disa nga strategjitë dhe taktikat specifike që u përdorën:

- **Përcaktimi i qëllimeve të qarta:** Filloi me një përcaktim të qartë të qëllimeve të projektit.
- **Komunikimi efektiv:** Komunikimi është çelësi për suksesin e projektit.
- **Përdorimi i aftësive dhe përvojës së ekipit:** Sigurimi i një ekipi të përshtatshëm për çdo detyrë dhe përdorimi i aftësive të tyre për përfitimin e projektit.

Arritjet dhe Sukseset Kryesore

Një nga arritjet kryesore dhe momentet e suksesit që kemi përjetuar gjatë projektit të përkushtuar për të promovuar lumturinë e fëmijëve është krijimi i një mjedisi tërësor ku fëmijët mund të ndjehen të sigurt dhe të lumtur. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, si lojëra, aktivitete artistike, dhe takimeve të grupit, ne krijuam një ambient të ngrohtë dhe të inkurajueshëm për fëmijët tanë.

Një shembull konkret është organizimi i një ditë të veçantë lojrash dhe aktiviteteve jashtë ambientit të shkollës. Ne u siguruam që të kishim një gamë të gjerë lojrash dhe aktiviteteve që të përputheshin me interesat dhe talentet e secilit fëmijë. Kjo ditë e veçantë u shënua nga buzëqeshjet e fëmijëve dhe ndjenja e gëzimit që përshkoi gjithë ambientin.

Gjatë prezantimit të këtij projekti para prindërve dhe stafit të shkollës, ne u përqendruam në sukseset tona në ndërtimin e një mjedisi pozitiv dhe mbështetës për fëmijët, si dhe në përpjekjet tona për të luftuar bullizmin në mënyrë efektive. Ky prezantim ngriti ndjenjën e bashkëpunimit dhe motivimit për të vazhduar këtë punë të rëndësishme edhe në vitet në vazhdim.

Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet

Identifikimi i mësimeve që nxorën nxënësit gjatë projektit është një proces i rëndësishëm për të përmirësuar dhe zhvilluar projekte të ngjashme në të ardhmen. Disa nga mësimet që nxorën nxënësit gjatë projektit” Jo bullizmit, Po lumturisë së fëmijëve“ janë:

- Ndërgjegjësimi për mirëqenie të fëmijëve: Nxënësit përjetuan rëndësinë e mirëqenies emocionale dhe sociale të fëmijëve. Nëpërmjet këtij projekti, ata u ndërgjegjësuam për impaktin pozitiv që mund të kenë veprimet e tyre në mirëqenien e të tjerëve.
- Ndërgjegjësimi i rëndësisë së bashkëpunimit: Projekti u lejoi nxënësve të ndërgjegjësohen për rëndësinë e bashkëpunimit dhe punës së ekipit për të

arritur qëllimet e përbashkëta për të siguruar lumturinë e fëmijëve në shkollë.

- Zhvillimi i aftësive të komunikimit: Përvoja në projektin e ndihmoi nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre të komunikimit në bashkëpunim me njëritjetrin, stafin shkollor dhe prindërit për të ndërtuar një ambient mbështetës për fëmijët.
- Promovimi i përgjegjësisë sociale: Përvoja e projektit ndihmoi nxënësit të kuptojnë përgjegjësinë e tyre për të ndikuar në ndryshimin pozitiv të klimës shkollore dhe për të mbrojtur fëmijët nga bullizmi dhe ndjenjat e vetmisë.

Në bazë të mësimave të nxjerra, disa rekomandime për projekte të ngjashme në të ardhmen mund të jenë:

- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit dhe komunikimit midis nxënësve.
- Promovimi i një kulture të përfshirë dhe mbështetëse në shkollë, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive të prindërve dhe stafit shkollor në aktivitete të mirëqenies së fëmijëve.
- Krijimi i një ambienti shkollor që promovon ndërgjegjësimin e ndjeshmërisë ndaj nevojave të të tjerëve dhe përgjegjësinë sociale të nxënësve.
- Sigurimi i financimeve dhe burimeve për të ndërtuar dhe zbatuar projekte të tilla në mënyrë që të mund të jenë efektive dhe të qëndrueshme në kohë.


Përfundimi

Përvoja ime në projekt ishte një udhëtim frymëzues . Duke punuar në këtë projekt, unë mësova thellësisht rëndësinë e ndërgjegjësimit të mirëqenies së fëmijëve dhe përkushtimit për të krijuar një ambient mbështetës për ta në shkollë.

Nëpërmjet këtij projekti, unë kuptova se bashkëpunimi dhe komunikimi janë thelbësore për të arritur qëllimet e përbashkëta për të siguruar lumturinë dhe mirëqenien e fëmijëve. Gjithashtu, u rikujtua për mua rëndësia e përgjegjësisë sociale dhe ndërgjegjësimit të nevojave të të tjerëve.

Kjo përvojë më frymëzoi të vazhdoj të angazhohem në projekte të ngjashme dhe të promovoj një kulturë të mbështetjes dhe ndërgjegjësimit për mirëqenien e të tjerëve. Mësova se edukimi dhe përgatitja e nxënësve për të qenë ndryshues pozitivë në mjedisin e tyre është një detyrë e rëndësishme dhe frymëzuese për të ardhmen.

Foto nga veprimtaritë



Shkolla 9 vjeçare “Çajupi”, Gjirokastër

Titulli i Projektit: Unë kam talent. Unë mundem

Projekti “**Unë kam talent. Unë mundem**” i zbatuar në shkollën tonë për nxitjen e arsimit gjithëpërfshirës ka shërbyer si një frymëzim i rëndësishëm për të gjithë komunitetin shkollor. Ky projekt ka qenë një përpjekje e përbashkët për të siguruar që të gjithë nxënësit tanë të kenë qasje të barabartë në arsim dhe të ndjehen të përfshirë në procesin mësimor. Me përkushtimin e stafit pedagogjik dhe mbështetjen e aktorëve të shkollës, projekti ka arritur suksese të konsiderueshme. Nëpërmjet përdorimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe miqësore kemi arritur të rrisim angazhimin dhe performancën e nxënësve tanë. Rezultatet pozitive kanë përfshirë përmirësimin e rezultateve akademike, rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të individëve me aftësi të kufizuara, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe tolerancës në mes të nxënësve me veçori dhe përvoja të ndryshme. Kjo përvojë e krijuar përmes zbatimit të projektit është bërë një model i frytshëm për të promovuar diversitetin dhe për të ndërtuar një mjedis shkollor të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë nxënësve tanë.

Një Përmbledhje e Shkurtër

Gjithëpërfshirja në arsim u krijon shanse të barabarta për zhvillim të gjithë fëmijëve me apo pa nevoja të veçanta dhe ju mundëson të nxjerrin në pah vlerat personale .Përmirësimi i infrastrukturës duke ndërtuar një klasë burimore ka ndihmuar fëmijët me nevoja të veçanta të pajisen me aftësi dhe të nxjerrin në pah talentin e tyre, të shijojnë arsimimin dhe të fitojnë besimin në vetvete. Gjatë kësaj periudhe u krijua një mjedis i përshtatshëm (klasë), me hapësirë të bollshme, me ndriçim dhe i mirë ajrosur në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastër (lyerje, sistemime). U pajis me bazë materiale të domosdoshme për zhvillimin e aktiviteteve artistike dhe sportive .U trajnuan mësueset ndihmëse që punojnë me nxënësit me aftësi ndryshe. Janë zhvilluar disa aktivitete , ekspozite me vizatime , krijimi i materialeve të riciklueshme, lojëra sportive . Kjo hapësirë e dedikuar shërben si një mjedis qetësues për fëmijët me nevoja të veçanta dhe jo vetëm.

Ekipi i stafit pedagogjik që mundësoi zhvillimin e projektit dhe kontributi i tyre

Mësuesit ndihmës , mësuesit kujdestarë, psikologja e shkollës dhe drejtorja e shkollës kontribuan me ide dhe përvojë për zhvillimin e këtij projekti . Mësueset ndihmëse sollën idenë se një klasë burimore do ti ndihmonte fëmijët

të nxjerrin në pah talentin e tyre dhe të fitonin besim në vetvete, mësuesit kujdestare dhe lëndorë me veprimtaritë e ndryshme nëpër klasat respektive . Psikologja e shkollës me zhvillimin e e orëve mësimore lidhur me aftësinë për jetën.

Përparësitë dhe Sfidat

Përmirësimi i infrastrukturës, pajisja me mjete, zhvillimi i aktiviteteve artistike, sportive ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë që nxënësit me aftësi ndryshe të përfshiheshin në procesin mësimor, të rritet performanca e tyre, të zhvillojnë talentin e tyre si p.sh. pikturë, muzikë, sport. U krijua një frymë pozitive bashkëpunimi duke ndërtuar një mjedis të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë nxënësve tanë. Projekti në vetvete ishte sfidues sepse kërkohet bashkëpunimi i të gjithëve; mësues, mësues ndihmës, psikologja e shkollës, Bashkia, Drejtoria e shkollës si për krijimin e klasës burimore por edhe për ideimin dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme për ti ardhur në ndihmë sa më mirë nxënësve.

Strategjitë dhe taktikat që u përdorën

Komunikimi i vazhdueshëm me Bashkinë bëri të mundur që punimet e nevojshme si lyerja dhe sistemime të ndryshme të bëheshin brenda kohës së parashikuar.

Takimet e organizuara me mësuesve ndihmës ,prindër dhe psikologes së shkollës na ndihmuan për të ideuar dhe planifikuar veprimtaritë e ndryshme që u zhvilluan dhe do të zhvillohen në të ardhmen .

Planifikimi dhe realizimi i temave mbi diskriminimin, diversitetin dhe gjithëpërfshirjen nga mësuesit kujdestarë dhe psikologja e shkollës për uljen e qëndrimeve diskriminuese ndaj fëmijëve me aftësi të veçanta dhe për përfshirjen e nxënësve të tjerë për t'ju ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi ndryshe.

Takime të mësuesve ndihmës dhe mësuesve të edukimit fizik , vizatimit , biologjisë dhe edukimit muzikor për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive për mbështetjen e edukimit të nxënësve , zhvillimin social, konjitiv dhe motorik.

Trajnime të mësuesve ndihmës.

Arritjet dhe Sukseset Kryesore

- Përfshirja e nxënësve me aftësi ndryshe në veprimtaritë e realizuara
- Realizimi i një mjedisi të dedikuar nxënësve me aftësi ndryshe, nxënësve me vështirësi në të nxënë , nxënësve të talentuar .
- Krijimi një klime pozitive dhe gjithëpërfshirëse në komunitetin shkollor.

Mësimet e Nxjerra

Mirëplanifikimi i hapave që duhen ndjekur për realizimin e projektit dhe koordinimi i punës me të gjithë aktorët e projektit kontribuon dhe është faktor kyç në arritjen e suksesit .

Krijimi i grupeve të punës për realizimin e veprimtarive dhe zhvillimi i tyre të bëhet me rigorozitet dhe përgjegjshmëri duke mbajtur në fokus gjithëpërshirjen dhe krijimin e një klime pozitive .

Realizimi i projekteve të tilla që nxisin , promovojnë gjithpërshirjen dhe krijojnë lehtësira dhe mundësi në zhvillimin dhe aftësimin e nxënësve me aftësi ndryshe, nxënësve me vështirësi në të nxënë apo nxënësve të talentuar të kthehen në praktika pozitive në institucionet tona arsimore .

Realizimi i këtyre projekteve ju krijon mundësinë fëmijëve të ndjehen të përfshirë, të shpalosin potencialin e tyre dhe të sjellin ndryshimin sado i vogël qoftë ai.

Përfundimi

Ky projekt është një përvojë pozitive nga njëra anë për impaktin që solli te komuniteti shkollor dhe nga ana tjetër për eksperiencën personale profesionale të fituar në realizimin e tij . Puna e vazhdueshme me grupe të ndryshme, komunikimi me aktorë të jashtëm, pjesëmarrja në takimet e planifikuara me mësuesit ndihmës, mësuesit kujdestarë , prindërit dhe realizimi i veprimtarive me nxënësit të mëson të kuptosh se është i nevojshëm dhe i domosdoshëm kontributi i sa më shumë njerëzve dhe profesionistëve për tju krijuar mundësi fëmijëve që të zhvillojnë aftësitë e tyre për jetën dhe të ardhmen.

FOTO TË VEPRIMTARIVE



Kopshti nr.3, Mat

Titulli i Projektit: : “Një kopësht miqësor për të gjithë”

Projekti “Një kopsht miqësor për të gjithë” i zbatuar në kopshtin tonë për nxitjen e arsimit gjithëpërfshirës ka shërbyer si një frymëzim i rëndësishëm për të gjithë komunitetin brenda dhe jashtë kopshtit. Ky projekt ka qenë një përpjekje e përbashkët për të siguruar që të gjithë fëmijët tanë të kenë qasje të barabartë në arsim dhe të ndjehen të përfshirë në procesin edukative. Me përkushtimin e stafit pedagogjik dhe mbështetjen e aktorëve të kopshtit, projekti ka arritur suksese të konsiderueshme. Nëpërmjet përdorimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe miqësore kemi arritur të rrisim angazhimin dhe performancën e fëmijëve, prindërve, anëtarë komuniteti. Rezultatet pozitive kanë përfshirë përmirësimin e arritjeve të të nxënimit kryesisht në lexim dhe në matematikë tek fëmijët e grupmoshës 3-6 vjeç, rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe forcimin e bashkëpunimit mes partnerëve familje, kopsht në dobi të mirëqenies psiko-emocionale dhe sociale të fëmijëve, informacione të vazhdueshme për lehtësim në regjistrimin e fëmijëve për një tranzicion sa më të qetë. Kjo përvojë e krijuar përmes zbatimit të projektit është bërë një model i frytshëm për të promovuar diversitetin dhe për të ndërtuar një mjedis i sigurt, i lumtur dhe i shëndetshëm në kopsht të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë fëmijëve 3-6 vjeçarë.

Një Përmbledhje e Shkurtër

Qëllimi i projektit: Kushte bashkëkohore dhe shërbim cilësor të stimulojë rritjen dhe zhvillimin e fëmijës që vjen nëpërmjet lodrave, socializimit dhe mësimit në grup.

Rezultatet:

- Përmirësimi i praktikave gjithëpërfshirëse ndaj të nxënimit të fëmijëve në moshë të hershme.
- Numri i regjistrimeve në kopsht për grupet e para.
- Një plan që shërben për krijimin ose përmirësimin e klimës pozitive në kopsht

Numri i përfituesve fëmijëve, prindërve, mësuesve, komunitetit dhe shoqërisë nga një kopsht miqësor:

- 110 fëmijë total 59 Femra 51 Meshkuj të grupmoshës 3-6 vjeç, 1 drejtuese dhe 9 mësuese dhe dy mësuese ndihmëse Femra, 6 personel

ndihmës.

- 75 fëmijë 43 femra dhe 32 meshkuj.
- 2 fëmijë me aftësi të kufizuar Meshkuj të grupmohës 4 vjeç.
- 4 fëmijë me probleme në të nxënë 1 F 3 M
- 170 të rinj dhe të reja të zonës ku ndodhet Kopshti Nr.3, Burrel
- 30 të moshuar
- 2 Mjekë dhe 8 infermierë tek Qendra Shëndetësore përballë kopshtit
- 1 drejtuese çerdhe 4 edukatore dhe 2 personel të çerdes.
- Drejtorja e higjienës

Ekipi i stafit pedagogjik që mundësoi zhvillimin e projektit dhe kontributi i tyre

Rritja e kapaciteteve të mësuesve përmes trajnimeve të shumta të bëra nga ekspertë të kontraktuar nga organizata Save the Children ka kontribuar në zhvillimin e tyre profesional dhe takimet e vazhdueshme mujore me stafin IPSED ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e grupeve të fuqizuara për ti vazhduar në punën edukative sipas grupmohave të fëmijëve, në përshtatjen e tyre në kopsht duke ndërtuar klimë pozitive dhe të sigurt dhe duke nxitur 5 fushat e të nxënës, Përmes modulit “Gati për të nxënë”, aktivitete edukative gjithëpërfshirëse dhe komunitare ku edukatorët janë bërë trajnerë, modele pozitive për të shkëmbyer eksperiencat e tyre në trajnim duke e ndarë jo vetëm me edukatorët e Kopshtit Nr.3 por me të gjitha edukatorët e kopshteve, Bashkia Mat me raste praktike dhe modele pozitive të mësimdhënies në fokus gjithëpërfshirja dhe të mësuarit përmes lojës për një edukim sa më cilësor dhe kalim të butë nga kopshti në shkollë.

Përparësitë dhe Sfidat

Të paturit e një kulture të përbashkët stafi pedagogjik në punën e përditshme me fëmijët e grupmohës 3-6 vjeç, ndërtimi i komunikimit pozitiv me të gjithë aktorët brenda dhe jashtë shkollës. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me prindër, anëtarë komuniteti një sfidë për ne pasi jo të gjithë prindërit kanë mendësitë për të pranuar ndryshimet dhe të bëhen pjesë aktive dhe vendimmarrëse brenda kopshtit , bashkëpunimi i të gjithë stafit me organizatën IPSED dhe Save the Children ka rritur ndjeshëm interesin dhe pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm prindërisht vulnerabël që ndikoi pozitivisht edhe në mënyrat e tyre të prindërimit dhe të ishin pranë jetës së kopshtit.

Strategjitë dhe taktikat

- Ndërtimi i urave të bashkëpunimit me stafin pedagogjik, strukturat vendimmarrëse brenda kopshtit Bordi i kopshtit, këshilli i prindërve dhe grupe prindërisht aktive për praktikat gjithëpërfshirëse në edukimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme.
- Bashkëpunimi me institucionet lokale dhe vendimmarrëse dhe OJF-të për të rritur kapacitetet e stafit pedagogjik për një klimë pozitive dhe edukim sa më cilësor e gjithëpërfshirës.
- Fuqizimi i prindërve si partnerë në mirëedukimin e fëmijëve të tyre.
- Baza materiale nga organizatat SC dhe IPSED i mundësojnë përgjatë procesit edukativ në klasë me larmishmëri metodash të të nxënës.

Arritjet dhe Sukseset Kryesore

- Prindërit kanë mësuar aftësi të reja prindërisht. Nxitja e metodave të komunikimit efektiv- prindërisht pozitiv = Disiplina Pozitive .
- Përkushtim dhe ndërveprim me fëmijët me anë të lojërave dhe aktiviteteve edukative
- Pjesëmarrje aktive në aktivitetet edukative organizuar nga stafi i kopshtit
- Prindërit ndihen më të motivuar për të bashkëpunuar me personelin e kopshtit, kur shikojnë se si fëmijët e tyre përfitojnë nga pjesëmarrja aktive në këto aktivitete.
- Prindërit janë të ndërgjegjësuar dhe kanë më shumë besim në aftësitë e tyre për të rritur fëmijën.
- Prindërit e fëmijëve të marginalizuar kanë më shumë informacion rreth institucioneve vendore.
- Frymë mikpritëse dhe ambient miqësor në kopshte dhe shkolla.
- Prindërit janë të interesuar për procesin e të mësuarit të fëmijëve të tyre.
- Prindërit aktivë ndajnë informacione me prindërit e tjerë.
- Prindërit, mësuesit dhe drejtuesit, kanë një model pozitiv dhe ndihen të fuqizuar për të zhvilluar aktivitete gjithëpërfshirëse brenda dhe jashtë kopshtit.
- Bashkëpunim efektiv për të identifikuar fëmijët e marginalizuar në komunitet.

Mësimet e Nxjerra dhe Rekomandimet

Përvoja e gjatë që prej vitit 2016 me organizatat IPSED dhe Save the Children dhe ekspertë nga ASCAP-i ka ndikuar pozitivisht për një frymë të re edukimi gjithëpërfshirës dhe komunitare në fëmijërinë e hershme në kopsht . Këmbim përvojash mes kolegësh më të njëjtën mision në punë edukative ,ë fëmijët e grupmoshave 3-6 vjeç ndikon pozitivisht në përdorimin e teknikave sa më pozitive, bashkëpunuese përmes lojës, integritit të të gjithë fëmijëve përfshirë edhe atyre të marginalizuar si fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë nga

komuniteti egjiptian dhe fëmijë nga familje me ndihmë ekonomike. Si edhe fuqizimi i rolit të prindërve për një prindërim sa më të mirë ndikon drejtpërdrejt në punën e përditshme me mësueset me fëmijët e tyre për një mirëqenie psiko-emocionale dhe sociale të tyre.

Trajnimet e vazhdueshme rrisin kapacitetet e edukatoreve për praktikat më të mira gjithëpërfshirëse në të nxënit e fëmijëve 3-6 vjeç si dhe për një kalim sa më të butë dhe të suksesshëm tranzicioni si për fëmijët që vijnë për herë të parë edhe për ato që shkojnë në shkollë.

Përfundimi

Kushte bashkëkohore dhe shërbim cilësor të stimulojë rritjen dhe zhvillimin e fëmijës që vjen nëpërmjet lodrave, socializimit dhe mësimi në grup. Krijimi i një klimë pozitive dhe mikpritëse në kopsht nëpërmjet aktiviteteve edukative, sociale dhe komunitare.

Të cilat ndikuan në përmirësimin e praktikave gjithëpërfshirëse ndaj të nxënit të fëmijëve në moshë të hershme; rritja e numrit i regjistrimeve në kopsht për të gjitha grupet.; rritja e numrit të përfituesve fëmijëve, prindërve, mësuesve, komunitetit dhe shoqërisë nga një kopsht miqësor;

Qëllimi i kopshtit nuk është vetëm t'ju vijë në ndihmë prindërve me orarin 8:00-17:00, por edhe të stimulojë rritjen dhe zhvillimin e fëmijës që vjen nëpërmjet lodrave, socializimit dhe mësimi në grup. Duke patur kushtet bashkëkohore dhe shërbimin cilësor, kemi bindjen se kjo nismë do të fuqizohet edhe më tepër në të ardhmen. Është rezultat i një pune të bërë me shumë dashuri për fëmijët, të ardhmen e këtij qyteti. (Një përmbledhje e shkurtër dhe motivuese e përvojës tuaj në projekt dhe çfarë mësoni nga kjo përvojë)

FOTO TË VEPRIMTARIVE



Shkolla 9 vjeçare “Mustafa Gjestila”, Mat

Titulli i Projektit: Krijimi i klasës burimore në ndihmë të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Projekti “Krijimi i klasës burimore në ndihmë të fëmijëve me nevoja të veçanta” i zbatuar në shkollën tonë për nxitjen e arsimit gjithëpërfshirës ka shërbyer si një frymëzim i rëndësishëm për të gjithë komunitetin shkollor. Ky projekt ka qenë një përpjekje e përbashkët për të siguruar që të gjithë nxënësit tanë të kenë qasje të barabartë në arsim dhe të ndjehen të përfshirë në procesin mësimor. Me përkushtimin e stafit pedagogjik dhe mbështetjen e aktorëve të shkollës, projekti ka arritur suksese të konsiderueshme. Nëpërmjet përdorimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe miqësore kemi arritur të rrisim angazhimin dhe performancën e nxënësve tanë. Rezultatet pozitive kanë përfshirë përmirësimin e rezultateve akademike, rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të individëve me aftësi të kufizuara, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe tolerancës në mes të nxënësve me veçori dhe përvoja të ndryshme. Kjo përvojë e krijuar përmes zbatimit të projektit është bërë një model i frytshëm për të promovuar diversitetin dhe për të ndërtuar një mjedis shkollor të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë nxënësve tanë.

Një Përmbledhje e Shkurtër

Në shkollën 9-vjeçare “Mustafa Gjestila”, Burrel është krijuar një klasë burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për tu ardhur në ndihmë të nxënësve me aftësi të kufizuara, ku katër prej tyre janë me diagnozë të moderuar dhe të rëndë, krijimi dhe pajisja e kësaj klase burimore ka motivuar dhe mbështetur këta nxënës në aftësitë dhe paaftësitë e tyre.

Klasa shërben si një lehtësuese për psikologun dhe mësuesit ndihmës në punën e tyre me nxënësit me aftësi të kufizuara. Si klasë burimore, shkolla ka vendosur një ambient të posaçëm në katin e parë, të rikonstruktuar si e gjithë godina e shkollës “Mustafa Gjestila” dhe e pajisur me bazë materiale falë mbështetjes dhënë nga Save the children.

Ekipi i stafit pedagogjik që mundësoi zhvillimin e projektit

Stafi pedagogjik që mundësoi zhvillimin e projektit janë:

- Drejtori
- Shërbimi psiko-social
- Mësuesit ndihmës
- Ekipi multidisiplinar

- Qeveria e nxënësve

Kontributi i stafit pedagogjik ne krijimin dhe funksionimin e klasës burimore ka qenë në vijimin e trajnimeve për hartimin e planeve PEI dhe përcaktimin e veprimtarive qe janë zhvilluar me nxënësit me aftësi ndryshe.

Përparësitë dhe Sfidat

Përparësitë:

- Rëndësia që i kushtohet nga MAS punës më nxënësit me aftësi ndryshe.
- Shkolla jonë ka tre mësues ndihmës që kanë kryer arsimin special të cilët punojnë me nxënësit me aftësi ndryshe
- Bashkëpunimi me Save the Children ishte një nga përparësitë kryesore.
- Trajnimi i ekipit të stafit që mundësoi projektin nga trajnerë të specializuar në hartimin e projekteve.
- Restaurimi i godinës së shkollës.
- Klasa burimore shërben dhe do të shërbejë në vitet ne vazhdimësi për tu ardhur në ndihmë fëmijëve me nevoja të veçanta dhe për të plotësuar nevojat e tyre për mësim dhe argëtim pra ka një impakt afatgjatë.
- Save the Children ka sponsorizuar për klasën burimore me materiale të ndryshme didaktike, relaksuese, argëtuese dhe kjo ka lehtësuar buxhetin e familjeve që kane fëmijë më AK dhe ka lehtësuar punën e mësuesve ndihmës.
- Mbështetja e prindërve në krijimin e klasës burimore.

Sfidat:

Në hartimin e këtij projekti kemi hasur një sërë sfidash ndër të cilat do përmendim:

- Përzgjedhja e idesë së projektit.
- Gjetja e një sponsori që të mbështesë stafin për realizimin e tij si nga ana financiare dhe trajnimet.
- Rezistenca e prindërve për të pranuar faktin se fëmija i tyre është me aftësi ndryshe ka qenë një nga sfidat e këtij projekti dhe mbetet edhe për të ardhmen.
- Menaxhimi i sjelljeve të nxënësve me diagnoza të rënda në lidhje me rregullat bazike te shkollës.
- Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi për të parë çdo arritje sado e vogël e tyre qoftë në aspektin mësimor, sjellje dhe aspektin social.
- Rritja në aspektin profesional të mësuesve ndihmës për të qenë më të informuar për ndryshimet e reja që ndodhin gjatë punës së përditshme.

Strategjitë dhe taktikat

- Shkolla jonë ka disa gjëra që duhen përmirësuar dhe përzgjedhja e idesë së projektit ishte sfidë më vete. U hodhën disa ide nga anëtarët e stafit, prindër dhe nxënës dhe në fund u vendos për projektin në fjalë bazuar në nevojat më adekuate të shkollës dhe mundësitë financiare. U përdor strategjia e varkës që po mbytej. Nga varka u hodhën idetë për të shpëtuar varkën dhe e fundit mbeti ideja për klasën burimore.
- Grupi i punës kontaktoi me Save the Children të cilit iu prezantua projekti dhe ku gjeti mbështetje të plote financiare për trajnimin e grupit të punës dhe bazën materiale të nevojshme.
- Trajnimi i mësuesve ndihmës nga agjenci të akredituara trajnuese mbi modulet për punën e nxënësve me AK.
- Bashkëpunimi me prindërit dhe sidomos të nxënësve me aftësi ndryshe.
- Pjesëmarrja e prindërve në aktivitetet e zhvilluara në klasën burimore.
- Promovimi i suksesëve të nxënësve me AK.

Arritjet dhe Sukseset Kryesore

- Krijimi i klasës burimore.
- Pajisja e saj me mjetet e nevojshme.
- Menaxhimi i sjelljeve të pakontrolluara.
- Përfshirja e nxënësve me AK në grupe të ndryshme brenda dhe jashtë klasës.
- Arritjet në aspektin mësimor, edukativ.
- Qëndrimi për një kohë më të gjatë në klasë.

Mësimet e Nxjerra dhe Rekomandimet

- E rëndësishme në një projekt është hedhja e ideve dhe zgjedhja e idesë më të përshtatshme.
- Pajisja e institucioneve arsimore me mësues të arsimit special si dhe bazën materiale që u shërben fëmijëve me aftësi ndryshe për plotësimin e nevojave të tyre bën që institucionet arsimore të jenë më gjithëpërfshirëse.
- Bashkëpunimi me organizata si Save the Children e ka bërë punën me nxënësit me aftësi ndryshe cilësisht më të mirë ku përfitues të jenë nxënësit, prindërit dhe mësuesit.

Rekomandime:

- Përvoja e fituar në këtë projekt të përdoret për të realizuar projekte të tjera të nevojshme për shkollën.
- Vijimin e bashkëpunimit me organizata jofitimprurëse dhe sponsor të ndryshëm si në rastin konkret për të pasur sukses në projekte ku shkolla nuk mundet e vetme.

Përfundimi

Si përfundim themi se projekti i realizuar pati sukses dhe është një shembull për tu ndjekur edhe nga shkollat e tjera. Puna me fëmijët me aftësi të kufizuara na ka bërë që ne që punojmë drejtpërsëdrejti me këto fëmijë të na ndryshojnë pritshmëritë e jetës tonë.

FOTO TË VEPRIMTARIVE



Shkolla 9 vjeçare “Hamit Mullisi”, Elbasan

Titulli i Projektit: Eliminimi i fenomenit të Bullizmit në shkollë

Projekti “Eliminimi i fenomenit të Bullizmit në shkollë” i zbatuar në shkollën tonë për nxitjen e arsimit gjithëpërfshirës ka shërbyer si një frymëzim i rëndësishëm për të gjithë komunitetin shkollor. Ky projekt ka qenë një përpjekje e përbashkët për të siguruar që të gjithë nxënësit tanë të kenë qasje të barabartë në arsim dhe të ndjehen të përfshirë në procesin mësimor. Me përkushtimin e stafit pedagogjik dhe mbështetjen e aktorëve të shkollës, projekti ka arritur suksese të konsiderueshme. Nëpërmjet përdorimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe miqësore kemi arritur të rrisim angazhimin dhe performancën e nxënësve tanë. Rezultatet pozitive kanë përfshirë përmirësimin e rezultateve akademike, rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të individëve me aftësi të kufizuara, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe tolerancës në mes të nxënësve me veçori dhe përvoja të ndryshme. Kjo përvojë e krijuar përmes zbatimit të projektit është bërë një model i frytshëm për të promovuar diversitetin dhe për të ndërtuar një mjedis shkollor të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë nxënësve tanë.

Një Përmbledhje e Shkurtër

Shkolla 9 vjeçare Hamit Mullisi është shkollë në të cilën studiojnë 188 nxënës në të cilët 53 janë nxënës të komunitetit rom dhe 17 janë nxënës të komunitetit egjiptian.

Në vitet e shkuara fenomeni i bullizmit ka ekzistuar në një masë mesatare, por me ndërhyrjen dhe punën e stafit të mësuesve dhe të prindërve të nxënësve ky fenomen po vjen drejt eliminimit të tij. Të gjithë aktorët kanë nevojë për ndihmë të specializuar për eliminimin e fenomenit.

Ekipi i stafit pedagogjik që mundësoi zhvillimin e projektit dhe kontributi i tyre

Mësuesit të cilët u përfshinë në realizimin e qëllimeve të projektit janë/ mësuesja koordinatore e Qeverisë së nxënësve, punonjësja sociale, mësuesja ndihmëse, mësuesit kujdestarë, prindërit dhe të gjithë nxënësit e shkollës.

Përparësitë dhe Sfidat

Përparësi gjatë zhvillimit të projektit janë:

- U realizuan trajnime të mësuesve, prindërve dhe nxënësve të shkollës për eliminimin e fenomenit të bullizmit.
- U realizuan aktivitete të ndryshme artistike-sportive për ndërgjegjësimin

e të gjithë aktorëve që shkolla është një vend ideal për t'u mësuar dhe argëtuar të gjithë së bashku.

Sfidat

Në fund të projekti nuk u arritën të trajnohen të gjithë prindërit për eliminimin e fenomenit.

Strategjitë dhe taktikat

- Fokus grupe me nxënësit dhe mësuesit.
- Fokus grupe me nxënësit dhe prindërit.
- Takime me përfaqësues të shoqatës Rome dhe egjiptiane dhe përfaqësues të ZVAP Elbasan.

Arritjet dhe Sukseset kryesore

- U përgatitën postera dhe vizatime në shkollë që ndërgjegjësojnë për dukurinë e bulizmit;
- U vendosen në çdo klasë kodet e sjelljes në klasë dhe në korridoret e shkollës;
- U zhvilluan aktivitete sportive dhe kulturore me nxënësit e të gjitha klasave me synim socializimin e nxënësve dhe nxitjen e sjelljeve pozitive;
- U zhvilluan tryeza të rrumbullakëta me prindër të nxënësve dhe komunitetin për t'u njohur me fenomenin dhe mundësitë e eliminimit të tij.

Mësimet e Nxjerra

Takimet dhe diskutimet me të gjithë aktorët sjell eliminimin e çdo problemi që mund të lindë në ambientet e shkollës dhe jashtë saj.

Përfundimi

Në përfundim të projektit u vu re që të gjithë nxënësit, prindërit dhe komuniteti rreth shkollës është shumë i informuar rreth fenomenit të bullizmit dhe mënyrat se si ta eliminojnë atë në vende dhe ambiente të ndryshme.

Realizimi i këtij projekti ishte një përvojë shumë e mirë për të gjithë aktorët që morën pjesë, të cilën stafi mësimor i shkollës në bashkëpunim me prindërit dhe nxënësit do ta zhvillojnë më tej.

FOTO TË VEPRIMTARIVE



Shkolla 9 vjeçare LAZARAT, Gjirokastrë

Titulli i Projektit: Shkolla për jetën - Drejt profesioneve

Projekti “Shkolla për jetën. Drejt profesioneve“ i zbatuar në shkollën tonë për nxitjen e arsimit gjithëpërfshirës ka shërbyer si një frymëzim i rëndësishëm për të gjithë komunitetin shkollor. Ky projekt ka qenë një përpjekje e përbashkët për të siguruar që të gjithë nxënësit tanë të kenë qasje të barabartë në arsim dhe të ndjehen të përfshirë në procesin mësimor. Me përkushtimin e stafit pedagogjik dhe mbështetjen e aktorëve të shkollës, projekti ka arritur suksese të konsiderueshme. Nëpërmjet përdorimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe miqësore kemi arritur të rrisim angazhimin dhe performancën e nxënësve tanë. Rezultatet pozitive kanë përfshirë përmirësimin e rezultateve akademike, rritjen e ndjeshmërisë ndaj nevojave të individëve me aftësi të kufizuara, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe tolerancës në mes të nxënësve me veçori dhe përvoja të ndryshme. Kjo përvojë e krijuar përmes zbatimit të projektit është bërë një model i frytshëm për të promovuar diversitetin dhe për të ndërtuar një mjedis shkollor të ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë nxënësve tanë.

Një Përmbledhje e Shkurtër

Projekti lindi si një ide për të adresuar nxënësit drejt botës së punës. Shkolla në këtë rast u kthye jo vetëm në këshilltarin e karrierës por me anë të këtij projekti hodhi hapa konkrete dhe të prekshëm për t'u gjendur pranë nxënësve me ofrimin e praktikave të vogla të punës si:

- Qëndisje me dore
 - Punim në makine qepëse
 - Vizita në punishte artizanale qëndistarie, të përpunimit të drurit dhe gurit.
- Sigurisht projekti nuk është me përmasa shume të mëdha por ne jemi munduar që përmasat t'ia rrisim nëpërmjet pjesëmarrjes së nxënësve si dhe sigurimit nëpërmjet mbështetjes së Save the Children dhe sigurimit të një baze të konsiderueshme materiale për repartin e qëndistarisë.
- Është vërejtur një rritje e interesit të nxënësve për të frekuentuar kurset tona të cilat në shpresojmë t'i kthejmë së shpejti në qendra të vërteta për të ndarë përvojë dhe për të prodhuar produkte artizanale.

Ekipi i stafit pedagogjik që mundësoi zhvillimin e projektit dhe kontributi i tyre

Gjate zhvillimit të fazave të këtij projekti janë përfshirë mësues të angazhuar kujdestare si dhe mësueset koordinatorë të këtij projekti.

Mësuesit kujdestar dhe mësuesit e këshillimit të karrierës zhvilluan biseda me nxënësit për të orientuar zhvillimin e tyre gjatë dhe pas shkollës. Mësuesit e këshillimit të karrierës shoqëruan nxënësit gjatë vizitave të tyre në qendra të ndryshme artizanale të zonës. Mësuesit e angazhuar me SHQK dhe koordinatorët krijuan dhe zhvilluan kurse të vogla gjatë orëve të tyre. Gjithashtu koordinatorët e projektit koordinuan veprimtaritë e ndërmarra nga mësuesit pjesëmarrës për mbarëvajtjen e projektit

Përparësitë dhe Sfidat që ju përballuat

Përparësi:

- Mësuesit ishin të motivuar sepse e shikonin si një domosdoshmëri dhe kjo e lehtësoi shumë punën e koordinatorëve.
- U rrit fryma e bashkëpunimit gjatë koordinimit të veprimtarive.
- Aktivitetet ishin gjithëpërfshirëse dhe zhvilluan ndjenjën e eupatisë së fëmijëve.

Shembull: Gjatë vizitave në qendrat e ndryshme fëmijët garonin për të përdorur mjetet artizanale me entuziazëm.

Sfida:

- Orientimi i pritshmërive të së ardhmes së nxënësve drejt tregut të punës dhe arsimit profesional.
- Menaxhimi i kohës së lirë të nxënësve nëpërmjet aktiviteteve artizanale duke kaluar kështu në plan të dytë varësinë nga rrjetet sociale.

Strategjitë dhe taktikat

Duke qenë se mësuesit e shkollës sonë i njohin mirë nxënësit dhe stilet e tyre të të nxënësve është punuar në mënyra të ndryshme me nxënës të ndryshëm.

Është punuar në mënyrë individuale, në grupe të vogla dhe të mëdha. Është promovuar një praktikë e mirë e cila ka nxitur interes dhe gare mes pjesëmarrësve. Sigurisht është përdorur edhe shpjegimi i procesit të punës nga njerëz me përvojë dhe më e rëndësishmja nxënësit kanë praktikuar vetë të krijojnë produkte të vogla artizanale. Sigurisht që vazhdimësia do ta bëjë produktin më të dukshëm, më të suksesshëm për të arritur pritshmërinë e realizimit të një panairi të vogël me këto produkte.

Arritjet dhe Sukseset Kryesore

- Nxënësit e shohin të ardhmen nga një këndvështrim praktik.
- Ka një rritje të interesit të nxënësve për të mësuar “hilet e zanatit”
- Është rritur numri i nxënësve që përdorin makinën qepëse për tegele të

ndryshme për kthime anësore ose tegele dekori.

Është rritur numri i nxënësve që interesohen për qëndistarinë me dore ndërsa akoma nuk kemi arritur të përdorim si duhet qëndistarinë në makinë për shkak të mungesës së informacionit mbi programin e përdorimit.

Mësimet e Nxjerra dhe Rekomandimet

Mësuam se duhet të provojmë që të arrijmë. Kuptuam nga kjo përvojë që mjafton të nxitesh motivimin te nxënësit dhe ti drejtosh në rrugën e tyre që ata të ecin të sigurt drejt saj. Shkolla jonë në këtë rast përmbushi një pritshmëri të veten për të qenë jo vetëm një burim dijesh por edhe një qendër praktike për të mësuar diçka e cila mund të të hyjë në punë. Nëse edhe komunitetit i paraqet një projekt konkret ai arrin të përfshihet, të japë ndihmesën e vet dhe të jetë bashkëpunëtor aktiv i shkollës.

Projekte që nxisin gjithëpërfshirjen dhe drejtimin drejt karrierës të mbështetura nga veprimtari praktike të cilat rrisin aftësitë për të vënë në punë njohuritë e marra duhet të vazhdojnë të mbështeten në të gjitha nivelet

Përfundimi

Ky është një projekt që bën bashkë probleme të jetës reale dhe interesat e nxënësve. Si i tillë ishte një sfidë në vetvete e cila bëri të dëgjohej zëri i nxënësit në zgjedhjen që bënë, të kishte një produkt publik dhe të rriste gjithëpërfshirjen, bashkëpunimin origjinalitetin e tyre. Projekte të tilla rrisin entuziazmin, i përfshijnë nxënësit, i motivojnë dhe i përgatisin për sfidat e jetës.

FOTO TË VEPRIMTARIVE

